



Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

**KODEKS PËR SJELLJE ETIKE PËR ANËTARËT E QEVERISË DHE BARTËSIT E FUNKSIONEVE TË EMËRUAR
NGA ANA E QEVERISË**

Shtator, viti 2020



Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Për të siguruar punë sipas ligjit, të ndershme, transparente dhe të përgjegjshme të anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, zëvendësministrave dhe bartësve e funksioneve publike të emëruar nga ana e Qeverisë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 22.09.2020, përcaktoi

KODEKS PËR SJELLJE ETIKE PËR ANËTARËT E QEVERISË DHE BARTËSIT E FUNKSIONEVE TË EMËRUAR NGA ANA E QEVERISË

PJESA I

PËRCAKTIMET E PËRGJITHSHME

Lënda për rregullimin e kodeksit

Neni 1

Me këtë kodeks përcaktohet mënyra e sjelljes dhe e punës së kryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, ministrave, zëvendësministrave dhe bartësve tjerë të funksioneve ekzekutive të emëruar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, (më tutje në tekst: bartës të funksioneve ekzekutive), për të mundësuar respektim të kushtetutshmërisë, ligjshmërisë, integritetit personal, efikasitetit, lojalitetit, përgjegjësisë, transparencës dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, gjegjësisht obligimeve në suaza të Kushtetutës, ligjeve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Qëllimi i kodeksit

Neni 2

Qëllimi i kodeksit është forcimi i integritetit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, ministrive dhe organeve tjera të administratës shtetërore si dhe të personave juridik të themeluar nga Qeveria (më tutje të tekst: institucione) dhe forcimin e besimit të qytetarëve në punën e tyre.



Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

PJESA II

PRINCIPET THEMELORE

Principet dhe standardet themelore

Neni 3

Bartësit e funksioneve ekzekutive në realizimin e funksionit të tyre obligohen për realizimin e principeve themelore të këtij kodeksi dhe standardeve të sjelljes siç janë:

- sundimi i ligjit,
- realizimi i interesit publik,
- respektim dhe mbrojtje të imazhit të Qeverisë dhe institucioneve,
- bashkëpunim, efikasitet dhe ekonomizim,
- ndershmëri, transparencë dhe përgjegjshmëri
- përfshirje, orientimi drejt konsensualitetit dhe
- përgjegjësi

Principi i sundimit të ligjit

Neni 4

Bartësit e funksioneve ekzekutive i ushtrojnë kompetencat dhe detyrat e tyre në përputhje me Kushtetutën, ligjet, rregulloret tjera të sjella në bazë ligjore dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Bartësit e funksioneve ekzekutive sigurojnë se të gjithë që punojnë nën kompetencat e tyre kanë përgjegjësi të njëjtë ndaj Kushtetutës dhe ligjit, ndërsa Kushtetuta dhe ligjet zbatohen njëjtë për të gjithë.

Principi i realizimit të interesit publik

Neni 5

Bartësit e funksioneve ekzekutive në punën e tyre janë të përkushtuar ekskluzivisht në interesin publik në të mirën e përgjithshme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe qytetarëve të saj.

Bartësit e funksioneve ekzekutive nuk lejohet ta shfrytëzojnë funksionin e tyre për realizimin e interesit personal ose interesit të njerëzve të afërt, si dhe interesit të partisë politike ose ndonjë subjekti tjetër.



Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Bartësit e funksioneve ekzekutive vendosin marrëdhënie të mirëbesimit dhe bashkëpunim me qytetarët dhe personat juridik, duke treguar mirëkuptim dhe vullnet për të ndihmuar dhe jo të pengohet realizimi i të drejtave dhe interesave të tyre.

Bartësit e funksioneve ekzekutive ju përmbahen parimeve të drejtësisë dhe të përshtatshmërisë në ushtrimin e kompetencave të tyre diskrecionale.

Bartësit e funksioneve ekzekutive ju përmbahen ndalesave të përcaktuara në ligje dhe në këtë kodeks.

Principi i respektimit dhe mbrojtjes së imazhit të Qeverisë dhe institucioneve

Neni 6

Bartësit e funksioneve ekzekutive në punën e tyre kanë sjellje profesionale dhe ju përmbahen standardeve më të larta të sjelljes, gjegjësisht sillen me vëmendje të veçantë dhe respektim të personalitetit dhe imazhit të secilit individ.

Bartësit e funksioneve ekzekutive mbajnë llogari për sjelljen e tyre që të mos e dëmtojnë interesin ose imazhin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut (më tutje në tekst: Qeverisë) dhe institucionet me të cilat udhëheqin, gjegjësisht janë pjesëmarrës në udhëheqjen e tyre.

Bartësit e funksioneve ekzekutive në mënyrë të lirë dhe të hapur i shprehin qëndrimet e tyre në lidhje me politikën e propozuara, por në mënyrë solidare i mbështesin politikën dhe vendimet qeveritare nga momenti kur miratohen, ndërsa në paraqitjet e tyre publike, politikën i prezantojnë në përputhje me këtë kodeks.

Bartësit e funksioneve ekzekutive i respektojnë kompetencat e personave tjerë të zgjedhur dhe të emëruar, si dhe të të punësuarve në sektorin publik ndaj të cilëve sillen në përputhje me këtë kodeks.

Principi i bashkëpunimit

Neni 7

Në drejtim të principit të realizimit të interesit publik, bartësit e funksioneve ekzekutive bashkëpunojnë në mes vete, si dhe me bartësit tjerë të funksioneve publike.



Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Principi i efikasitetit dhe ekonomizimit

Neni 8

Bartësit e funksioneve ekzekutive në mënyrë racionale dhe në kohë të duhur i realizojnë detyrat, kompetencat dhe në mënyrë të arsyeshme i shfrytëzojnë resurset publike për arritjen e qëllimit të funksionit, gjegjësisht detyrës që e kryejnë, ndërsa qytetarët vlerësojnë rezultatin në lidhje me punën dhe mjetet e investuara.

Bartësit e funksioneve ekzekutive bëjnë kujdes që qytetarëve të mos detyrohen për shpenzime të panevojshme gjatë realizimit të së drejtave, obligimeve dhe interesit të tyre.

Principi i ndershmërisë, transparencës dhe përgjegjshmërisë

Neni 9

Bartësit e funksioneve ekzekutive rregullisht raportojnë për punën dhe sjelljen e tyre, si dhe për punën e institucionit me të cilin udhëheqin ose janë pjesëmarrës në udhëheqjen e tij, para opinionit, Qeverisë dhe Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Bartësit e funksioneve ekzekutive sigurojnë qasje në informacionet e karakterit publik në përputhje me ligjin, gjegjësisht në kohë, tërësisht dhe me vetiniciativë i japin publikut informacione dhe të dhëna nga puna e tyre, gjegjësisht puna e institucionit të tyre edhe atë në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, në formë të shkruar dhe elektronike, në ueb-faqen e institucionit.

Bartësit e funksioneve ekzekutive përgjigjen në mënyrë jo-selektive, në kohë dhe me argumente në pyetjet dhe komentet e opinionit dhe palëve të interesuara për të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me punën e institucionit të tyre.

Principi i përfshirjes dhe i orientimit drejt konsensualitetit

Neni 10

Në procesin e zhvillimit, implementimit dhe vlerësimit të politikave publike, bartësit e funksioneve ekzekutive i zbatojnë të gjitha format legjitime për pjesëmarrje dhe i përfshijnë të gjitha palët e interesuara.

Në zhvillimin, implementimin dhe vlerësimin e politikave publike, bartësit e funksioneve ekzekutive janë të përkushtuar drejt harmonizimit të interesave të ndryshëm në shoqëri për të arritur konsensus të gjerë për vendimet që do të jenë në interes për të gjithë qytetarët pa dallim të përkatësisë së tyre



Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

etnike, partiake, gjinore, orientimit seksual, racor, ngjyra e lëkurës, prejardhjes, përkatësisë së grupeve të marginalizuara, gjuhës, gjendjes sociale, arsimimit, religjionit, aftësive të kufizuara, moshës, gjendjes familjare apo martesore, statusit pronësor, gjendjes shëndetësore, statusit social, gjegjësisht interes për shoqërinë në përgjithësi.

Neni 11

Bartësit e funksioneve ekzekutive janë personalisht përgjegjës për punën e institucionit me të cilin udhëheqin ose që janë pjesëmarrës në udhëheqjen e tij, si dhe për punën e institucioneve ndaj të cilave kryejnë mbikëqyrje, gjegjësisht për vendimet dhe procedurat gjatë mandatit dhe implementimin e këtij kodeksi.

Bartësit e funksioneve ekzekutive janë personalisht përgjegjës për sjelljen e tyre në përputhje me Kushtetutën, ligjet dhe këtë kodeks, edhe atë para kryetarit të Qeverisë dhe para Kuvendit.

Kryetari i Qeverisë, ministrat (më tutje në tekst: anëtarët e Qeverisë) dhe zëvendësministrat janë lojal ndaj Qeverisë dhe kanë përgjegjësi kolektive për sjelljen e vendimeve qeveritare dhe realizimin e politikave qeveritare dhe punojnë bashkë me anëtarët tjerë të Qeverisë me qëllim që të arrijnë koherencë dhe harmonizim para vendimit për miratimin e tyre.

Ministrat dhe zëvendësministrat janë lojal ndaj kryetarit të Qeverisë, që me propozim të tij janë emëruar. Anëtarët e Qeverisë dhe zëvendësministrat janë të pranishëm në seancat në Kuvend gjatë shqyrtimit të ligjeve, akteve dhe materialeve që janë në kompetencën e tyre dhe në seancat për parashtrimin e pyetjeve të deputetëve dhe përgjigjen në pyetjet lidhur me realizimin e detyrave të tyre, duke përfshirë edhe pyetjet për mënyrën dhe qëllimin e shpenzimit të mjeteve nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.



Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

PJESA III

RREGULLAT E SJELLJES

Shmangia e konfliktit të interesit publik dhe privat

Neni 12

Bartësit e funksioneve ekzekutive, në realizimin e kompetencave dhe detyrave të tyre, shmangin çfarëdo lloj konflikti të interesit publik dhe privat, gjegjësisht arritjen në një situatë të ngritjes së dyshimeve për ekzistimin e konfliktit të interesit.

Bartësit e funksioneve ekzekutive, në realizimit të kompetencave dhe detyrave, ekskluzivisht japin llogari për respektimin e Kushtetutës, Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesit si dhe Ligjit për mbrojtje të sinjalizuesve (informatorëve) dhe rregulloret tjera, si dhe sigurojnë mekanizma për respektimin e tyre nga ana e të gjithë të punësuarve në institucionin që e udhëheqin.

Bartësit e funksioneve ekzekutive, funksionin e ushtrojnë si detyrë themelore dhe të vetme, gjegjësisht nuk guxojnë të ushtrojnë veprimtari tjetër e cila mund të ndikojë ndaj paanshmërisë në ushtrimin e kompetencave dhe detyrave dhe t'u përmbahen vazhdimisht dispozitave nga Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave për:

- ndalim i ushtrimit të aktiviteteve tjera,
- kufizime për ushtrim të një aktiviteti tjetër gjatë ushtrimit të funksionit,
- kufizime për mbikëqyrje,
- kufizime për ushtrim të një veprimtarie pas ndërprerjes së funksionit,
- ndalesë për anëtarësim në organe administrative dhe mbikëqyrjeje,
- ndalesë për keqpërdorim të të dhënave zyrtare,
- kufizime për bashkëpunim me persona juridik,
- ndalesë për shfrytëzim të huave dhe lloje të tjera të mbështetjes nga shteti,
- ndalesë për të pasur në dispozicion pronë shtetërore,
- shfrytëzim efikas i mjeteve shtetërore,
- ndalesë për blerjen e të drejtave aksionare,
- ndalesë për ndikim për punësim të familjarëve të afërm dhe
- ndalesë për ndikim për procedurat e prokurimit publik.



Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Bartësit e funksioneve ekzekutive vazhdimisht janë të qasshëm dhe të angazhuar për qëllimet në punë dhe jashtë vendit të punës, duke i shfrytëzuar aparatet elektronike, lidhjet telefonike dhe të internetit të cilat u jepen për qëllime zyrtare.

Ndarja e interesave shtetërore dhe ato partiake – pjesëmarrja në aktivitete partiake gjatë kohës së mandatit

Neni 13

Bartësit e funksioneve ekzekutive gjatë pjesëmarrjes në aktivitete partiake si anëtarë dhe si bartës të funksioneve në parti politike, kandidim ose avokim të partive dhe kandidatë për zgjedhje lokale, parlamentare ose presidenciale, nuk duhet ta cenojnë profesionalizmin dhe qasshmërinë në ushtrimin e funksionit, gjegjësisht detyrën, dhe gjithmonë prioritet do ta ketë funksionin, gjegjësisht detyrën.

Bartësit e funksioneve ekzekutive, jashtë orarit së punës të institucionit të cilin e udhëheqin, mund të marrin pjesë në aktivitete partiake si anëtarë të partive politike, të jenë kandidatë ose të avokojnë parti dhe të jenë kandidatë për zgjedhje lokale, parlamentare dhe presidenciale, por nuk duhet ta cenojnë profesionalizmin dhe qasshmërinë e funksionit, gjegjësisht detyrës të cilën e kryejnë, ndërsa para saj, dhe gjithmonë prioritet do ta ketë funksionin, gjegjësisht detyrën që e ushtrojnë.

Bartësit e funksioneve ekzekutive të cilët kanë qëllim që të marrin pjesë në zgjedhje do ta njoftojnë kryetarin e Qeverisë dhe anëtarin e Qeverisë i caktuar nga kryetari i Qeverisë si përgjegjës për monitorim dhe zbatim të këtij kodeksi, që të promovojë sjellje në përputhje me kodeksin dhe ta ndjeke zbatimin e tij nga ana e bartësve të funksioneve ekzekutive (më tutje në tekst: anëtar i Qeverisë – përgjegjës për monitorim dhe zbatim të kodeksit).

Marrëdhëniet me lobistët

Neni 14

Bartësit e funksioneve ekzekutive gjatë kontakteve me lobistë dhe organizata të lobimit vazhdimisht e respektojnë Ligjin për lobim.

Bartësit e funksioneve ekzekutive gjatë kontakteve me lobistë dhe organizata të lobimit, kur janë qëllim i lobimit:

- kanë kujdes që të mos vendosen në pozicion të konfliktit të interesit,
- i kanë parasysh qëllimet e lobimit që i kryen lobisti, gjegjësisht organizata e lobimit e cila e kontakton,



Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

- në situatë të konfliktit të interesit gjatë lobimit e ndërpresin kontaktin dhe refuzojnë çfarëdo kontakti të mëtutjeshëm me lobistin, gjegjësisht me organizatën e lobimit dhe përfaqësuesin e kësaj organizate,
- përgatisin raport, që përmban informacione për lëndën e diskutimit dhe identitetin e personave që kanë qenë prezent,
- publikojnë kopje nga raporti në ueb-faqe të institucionit me të cilin udhëheqin,
- publikojnë informacione për takime me lobistë dhe informacione për kontakt të realizuar me palë të treta, gjegjësisht palë tjera të interesuara.

Marrëdhëniet me të punësuarit në sektorin publik

Neni 15

Bartësit e funksioneve ekzekutive e respektojnë profesionalizmin dhe paanshmërinë e të punësuarve në sektorin publik, që në asnjë mënyrë nuk do të krijojnë situatë për sjellje në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për të punësuar në sektorin publik, Ligjin për shërbyes civil, ligjet tjera, marrëveshjet kolektive, Kodeksin për shërbyesit administrative dhe të kodekseve të institucioneve në të cilat punojnë.

Bartësit e funksioneve ekzekutive me sjelljen e tyre ndaj të punësuarve në institucionin me të cilin udhëheqin, gjegjësisht në udhëheqjen e të cilit marrin pjesë, sillen me respekt maksimal për personalitetin e tij dhe në asnjë mënyrë nuk do të ndikojnë për diçka që është në kundërshtim me ligjin.

Bartësit e funksioneve ekzekutive, gjatë punësimit, avancimit dhe përfundimit të punësimit në institucionin me të cilin udhëheqin, udhëhiqen nga kriteret e profesionalizmit, kompetencës dhe zbatimin e parimit të përfaqësimit adekuat dhe të drejtë të pjesëtarëve të bashkësive dhe aftësitë profesionale të kandidatëve dhe të të punësuarve në institucionin të cilin e udhëheqin dhe kujdesen për perspektivën gjinore.

Bartësit e funksioneve ekzekutive i kanë parasysh argumentet dhe këshillat profesionale të të punësuarve gjatë përgatitjes dhe miratimit të vendimeve dhe realizimit të politikave qeveritare.

Bartësit e funksioneve ekzekutive nuk do të ushtrojnë ndikim ndaj të punësuarve në sektorin publik që të anëtarësohen në çfarëdo shoqate, organizate ose partie, e as nuk do t'i shantazhojnë me avancim në karrierë dhe nuk mund të kërkojnë, e as të presin pjesëmarrje të të punësuarit në aktivitete të partisë politike.



Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Prezantimi i politikave

Neni 16

Bartësit e funksioneve ekzekutive nuk mund të veprojnë vetëm në emër personal, ndërsa deklaratat e dhëna, marrja pjesë, intervistat, publikimet në rrjete sociale duhet të jenë konsistente me politikën qeveritare dhe me programin për punë të miratuar nga Qeveria.

Nëse nga bartësit e funksioneve ekzekutive kërkohen komente dhe deklarata për punën e një institucioni që nuk është nën kompetencë të tij, dhe për të cilën përgjegjësi ka bartës tjetër i funksionit ekzekutiv, ata konsultohen me bartësin e funksionit ekzekutiv që është kompetent për atë çështje.

Bartësit e funksioneve ekzekutive janë të paanshëm dhe neutral ndaj të gjithë aktorëve në sferën e mediave dhe e respektojnë lirinë e pamohueshme të mediave.

Profilet zyrtare në mediat sociale të institucioneve dhe të bartësve të funksioneve ekzekutive janë burim primar për komunikim të politikave qeveritare, programeve, deklaratave dhe iniciativave.

Në publikimet në profilet e mediave sociale, gjatë të cilave bartësit e funksioneve ekzekutive marrin pjesë në emër të institucionit, nuk duhet të promovohen aktivitete partiake.

Pranimi i dhuratave

Neni 17

Bartësit e funksioneve ekzekutive gjatë kryerjes së funksionit dhe detyrave nuk mund të pranojnë dhurata, përveç në rastet, në vlerë dhe në mënyrë të caktuar me Ligjin për shfrytëzimin dhe posedimin e gjësëndeve në pronësi shtetërore dhe me gjësëndet në pronësi komunale, si dhe Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit.

Bartësit e funksioneve ekzekutive nuk duhet të kërkojnë, pranojnë, gjegjësisht të lejojnë që një person tjetër, në emër të tyre ose në interes të tyre të jep ose pranojë dhurata, shërbime ose çfarëdo gjëje tjetër me vlerë, ndihmë ose interes në lidhje me ushtrimin e funksionit, gjegjësisht detyrës, ndërsa e cila mund të kishte ndikim ose në çfarëdo lloj mënyrë e komprometon gjykimin ose e vendos në vartësi dhe detyrim joadekuat.

Bartësit e funksioneve ekzekutive nuk duhet të pranojnë nderime, dekorata dhe shpërblime nga shtete ose organizata të huaja gjatë kohës së ushtrimit të funksionit të tyre, gjegjësisht gjatë ushtrimit të detyrës së tyre, ndërsa në rast të këtyre nderimeve, ata konsultohen me Ministrinë e punëve të jashtme në lidhje me pranimin e nderimeve për çdo rast të veçantë.



Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Shfrytëzimi i resurseve materiale – integritet i funksionarëve në shpenzime, kompensime

Neni 18

Bartësit e funksioneve ekzekutive sigurojnë efikasitet maksimal, menaxhim dhe shfrytëzim ekonomik të mjeteve materiale, pajisjeve dhe lëndëve tjera që u janë besuar dhe e parandalojnë shfrytëzimin e paligjshëm të tyre, kujdesen për ndërmarrje të masave të duhura për siguruar lëndët e klasifikuara, i dhe largimin e mundësive për shkaktim të dëmit material në organin që udhëheqin.

Bartësit e funksioneve ekzekutive, hapësirat shtetërore dhe qeveritare, inventarin, mjetet teknike dhe financiare që i kanë në dispozicion në lidhje me ushtrimin e funksionit, i shfrytëzojnë në mënyrë të përgjegjshme dhe të ndërgjegjshme, dhe ekskluzivisht për ushtrim të funksionit.

Bartësit e funksioneve ekzekutive në çdo gjashtë muaj deri tek anëtari i Qeverisë i caktuar si përgjegjës për monitorim dhe zbatim të kodeksit paraqesin raporte për shpenzimet zyrtare të bëra gjatë ushtrimit të kompetencave dhe detyrave të tyre zyrtare, përveç në situata kur publikimi i këtyre informacioneve mund të paraqes rrezik për sigurinë. Për monitorim dhe ndershmëri para qytetarëve, të gjitha raportet janë publikisht të qasshme përmes zgjidhjes softuerike për publikim dhe vizualizim të shpenzimeve zyrtare në ueb-faqen zyrtare të Qeverisë.

Udhëtimet

Neni 19

Bartësit e funksioneve ekzekutive gjatë udhëtimeve të organizuara për qëllime partiake ose private nuk duhet t'i mbulojnë me mjete shtetërore, e as të shfrytëzojnë privilegjet që burojnë nga kompetencat dhe detyrat e tyre (dokumente diplomatike për udhëtim, sigurim dhe vozitës/veturë zyrtare) për qëllime private ose partiake, përveç kur i njëjti nuk bën pjesë në masa speciale për siguri.

Bartësit e funksioneve ekzekutive gjatë udhëtimeve zyrtare për angazhime profesionale në vendet e huaja udhëhiqen nga parimi për efikasitet, ekonomizim dhe sigurojnë aranzhimet më të pranueshme ekonomike.

Bartësit e funksioneve ekzekutive janë personalisht përgjegjës për madhësinë dhe përbërjen e delegacioneve zyrtare për udhëtim në vendet e huaja dhe të njëjtat duhet të jenë sa më të vogla në numër, duke i siguruar parakushtet e nevojshme për përmbushjen e duhur të qëllimeve të udhëtimit.



Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Në rrethana kur bartësi i funksionit ekzekutiv në udhëtimin e tij zyrtar në vendet e huaja është i/e shoqëruar nga partneri martesor, ai/ajo udhëton ekskluzivisht me shpenzime private. Kjo nuk e përfshinë partnerin martesor të kryetarit të Qeverisë kur udhëton si pjesë e delegacionit zyrtar.

Bartësit e funksioneve ekzekutive nuk mund të pranojnë udhëtim dhe akomodim që nuk janë të paguara për atë qëllim, përveç kur bëhet fjalë për pjesëmarrje në ngjarje zyrtare, takime dhe konferenca me ftesë ose ngjarje të tjera të karakterit diplomatik ose protokollar.

PJESA IV

ZBATIMI I KODEKSIT DHE PËRGJEGJËSIA PËR MOSRESPEKTIMIN E DISPOZITAVE TË KODEKSIT

Deklaratë për respektimin e kodeksit

Neni 20

Bartësit e funksioneve ekzekutive do të nënshkruajnë deklaratë me të cilën e konfirmojnë se do t'i përmbahen (do ta respektojnë) këtë kodeks gjatë ushtrimit të kompetencave, gjegjësisht detyrave të tyre.

Dorëzimi i raportit

Neni 21

Anëtari i Qeverisë – përgjegjës për monitorim dhe zbatim të kodeksit në çdo gjashtë muaj nga emërimi i tij dhe në afat prej 10 ditë para fundit të mandatit të Qeverisë, kryetarit të Qeverisë ia dorëzon raportin për respektimin e kodeksit nga bartësit e funksioneve ekzekutive.

Raportimi i dyshimit për konflikt të interesit

Neni 22

Me kërkesë të anëtarëve të Qeverisë, zëvendësministrave dhe funksionarëve të tjerë të emëruar nga Qeveria, me iniciativë vetanake ose njëzëri, deri tek anëtari i Qeverisë i caktuar përgjegjës për monitorim dhe zbatim të kodeksit, ky i fundit do t'i këshillojë për çdo gjë që ka të bëjë sjelljen dhe çështjet etike që kanë të bëjnë me këtë kodeks dhe do t'u japë rekomandime të përgjithshme për veprim të mëtutjeshëm. Të gjithë bartësit e funksioneve ekzekutive që përfshihen në dispozitat e këtij kodeksi, bashkëpunojnë me anëtarin e Qeverisë – përgjegjës për monitorim dhe zbatim të këtij kodeksi, i mundësojnë qasje tek të gjitha informacionet relevante që ai i kërkon, përveç nëse ato kanë karakter të informacioneve të klasifikuara.



Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Bartësit e funksioneve ekzekutive në kohë të duhur e informojnë kryetarin e Qeverisë dhe anëtarin e Qeverisë – i caktuar përgjegjës për monitorim dhe zbatim të kodeksit në rast të ekzistimit të dyshimeve që kanë të bëjnë zbatueshmërinë e këtij kodeksi gjatë ushtrimit të funksionit, gjegjësisht detyrës.

Masa në rast të mosrespektimit të Kodeksit

Neni 23

Në rast të mosrespektimit të dispozitave nga ky kodeks, anëtari i Qeverisë – përgjegjës për monitorim dhe zbatim të kodeksit, në mënyrë të shkruar dhe verbale i tregon bartësit të funksionit ekzekutiv se e ka shkelur kodeksin dhe i tregon që ta përmirësojë sjelljen. Paralajmërimi me shkrim u dërgohet të gjithë bartësve të funksioneve ekzekutive si masë e cila ka për qëllim të ndikojë në sjelljet e tyre në të ardhmen dhe të parandalojë shkelje tjera të kodeksit nga ana e bartësve të funksioneve ekzekutive.

Në rast të mosrespektimit të dispozitave nga ky kodeks, në bazë të mendimit të anëtarit të Qeverisë – i caktuar si përgjegjës për monitorim dhe zbatim të kodeksit, kryetari i Qeverisë mund të vendosë të ndër marrë ndonjë nga masat vijuese:

- shprehje të pakënaqësisë, gjegjësisht kritikë zyrtare për sjelljen e personit që nuk e ka respektuar këtë kodeks dhe kërkesë për ta përmirësuar sjelljen, gjë që mund të publikohet për opinionin,
- përgjegjësi politike, gjegjësisht kërkesë për dhënie të dorëheqjes së bartësit të funksionit ekzekutiv ose propozim për shkarkim të tij/ose
- ngritjen e iniciativës për informimin e institucioneve kompetente, më së voni në afat prej një muaji nga dita e zbulimit të mosrespektimit të këtij kodeksi, ligji, sidomos Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit, Ligjit për mbrojtje të sinjalizuesve dhe Ligjit për lobim.

Zbatimi i dispozitave të kodeksit të këshilltarëve

Ky kodeks do të zbatohet edhe për këshilltarët që janë të emëruar nga kryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe për këshilltarët e posaçëm të angazhuar nga ministrat të cilët gjatë nënshkrimit të marrëveshjes për angazhimin e tyre e nënshkruajnë edhe deklaratën për pranimin e këtij kodeksi.



Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

PJESA V

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 25

Me ditën e publikimit të këtij kodeksi, fillon të emërohet “Kodeks për sjellje etike të anëtarëve të Qeverisë dhe bartësve të funksioneve ekzekutive të emëruar nga ana e Qeverisë (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.176/19)

Neni 26

Ky kodeks publikohet në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Nr.

viti 2020

Shkup

**KRYETARI I QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**

Zoran Zaev